

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Zëvendësimi i rrjetit telefonik analog me teknologji VOIP”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

32412100-5 - Rrjeti i telekomunikacionit.

VLERA E FONDIT LIMIT:

18,400,000 (tetëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 18,000,000 (tetembedhjetë milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros per vitin e fundit financiar te jete ne masen paktën 18,000,000 (tetembedhjetë milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 7,000,000 (shtate milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën afërsisht 38 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afërsisht 38% të vlerës të fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuar) të leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituar nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*

- *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësive, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit;*

- *ISO 27001: për Menaxhimin e sistemit të sigurisë së informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit;*
- *ISO 20000-1: për Sistemin e menaxhimit te shërbimit të teknologjisë së informacionit, objekti i së cilës te ketë lidhje me objektin e prokurimit.*

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata për menaxhimin e cilesise ISO 9001: është referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit te sigurise se informacionit ISO 27001: është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit, për shkak te rendesise se veçante që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht ne sistemin elektro-energjitik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur nga Kontraktori. Certifikimi sipas kesaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurine e nevojshme AK. Sistemi i menaxhimit te sigurise se informacionit siguron qe operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përqsasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria. Menaxhimi i shërbimit IT siguron qe operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shërbimit ISO 20000-1: garanton se ofruesi i shërbimit objekt prokurimi eshte i certifikuar per të planifikuar, krijuar, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar një shërbim. Kërkesat përfshijnë projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e dakorduara të shërbimit, nepermjet sigurise se nevojshme per ecurine e punes se AK.

Kërkesa në lidhje me këtë certifikatë është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues, per realizimin e kontratës objekt prokurimi, duhet te kete punonjesit e nevojshem prej te pakten 3(tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, si me poshte:*

- ✓ *Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per sisteme telefonie ku te pakten njeri prej tyre te jete i certifikuar per rrjeta kompjuterike;*

- ✓ *Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar ne menaxhimin e sherbimeve IT, ITIL ose ekuivalent;*
- ✓ *Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per siguri ne rrjetat kompjuterike;*
- ✓ *Te pakten 2 (dy) punonjes te pajisur me deshmi te kualifikimit teknik per sigurimin teknik, nga te cilet te pakten nje prej tyre te jete ne Grupin IV, i kualifikuar per centrale, nenstacione dhe rrjete elektrike.*

Shenim: *Nje punonjes mund te kete me shume se nje certificate.*

Per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, per te gjithë stafin e kerkuar me sipër, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: listepagesat e-Sig per periudhen e kerkuar, deshmitë apo certifikatat qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për punonjesit e sipërpërmendur është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e tij tregtar këtë veprimtari.

Kërkesa per punonjes te certifikuar per sisteme telefonie, ku te pakten njeri nga ata te jete i certifikuar per rrjetat kompjuterike, synon te siguroje nje zbatim te sigurte te kontrates, si dhe efikas, ne perputhje me objektin e prokurimit.

Kërkesa per punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT, ITL ose ekuivalent eshte e rendesishme per te permiresuar efikasitetin e operacioneve dhe per te ofruar sherbime me te mira ndaj kerkuesve. Per shkak te ketyre certifikimeve, punonjesit jane ne gjendje te reduktojne nderprerjet e sherbimeve, duke permiresuar qendrushmerine dhe disponueshmerine e infrastruktures kritike, sic eshte AK. Po ashtu, ata kontribuojne ne parandalimin e incidenteve te sigurise he ofrojne garanci per nje operacion te sigurte dhe efikas.

Kërkesa per te pasur punonjes te certifikuar per siguri ne rrjetat kompjuterike eshte e rendesishme per sigurine dhe efikasitetin e rrjetave kompjuterike ne sektorin e punes se AK. Punonjesit e certifikuar per sigurine kane njohuri te thelluara per identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve te sigurise, duke siguruar mbrojtjen e infrastruktures kritike nga potenciale rreziqe te tilla.

Kërkesa per te pasur punonjes te kualifikuar sipas grupit IV, per centrale, nenstacione dhe rrjete elektrike eshte e rendesishme per sigurine dhe cilesine e sherbimit ne sektorin e energjise elektrike. Keto specialiste sigurojne qe operatori ekonomik te parandaloje incidente, te reagoje ne

emergjenca dhe te permbushe standardet e sigurise dhe cilesise, duke garantuar keshtu operacionet e sigurta dhe efikase te transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike.

Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesionale është në përputhje me Nenin 40, pika 5/c, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun e prodhuesit (te perkthyer dhe noterizuar) per mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te specifikojte se: Mallrat objekt procedure prokurimi janë të reja dhe të pa perdorura me parë.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, eshte vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".